



Pranuar / Dorezuar Prijmijeno / Priloz Received / Delivery	08.06.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMBHC	2963	2021	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.438/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2874/19 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.611/2019 të datës 08.10.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në rrugën “Hysni Talla”, Nr. 6/2, lagja Bregu i Diellit në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. Prot: 10443 të datës 24.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, në çështjen juridike **“pezullim nga puna”**, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.06.2021 mori këtë:

V E N D I M

Përfundim Procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.611/2019 e datës 08.10.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 03.07.2014 në vendin e punës “Drejtori i Departamentit të Automjeteve” në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, në bazë të Vendimit me Nr. Prot: 10443 të datës 24.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit është pezulluar nga puna deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. Prot: 10443 të datës 24.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.10.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4699/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 11.10.2019 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar tek Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit. Me datë 15.10.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës (faqe 1-8).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pas parasysh provat e lëndës në mënyrë që të nxirret vendim meritor, më datë 16.10.2019 ka kërkuar informata zyrtare nga Kryeprokurori i Shtetit *se ndaj ankuesit a janë duke u zhvilluar ndonjë procedurë hetimore apo a është ngritur ndonjë aktakuzë*. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit më datë 24.10.2019 nëpërmjet njoftimit ka njoftuar që *“Bazuar në nenin 6 të Rregullores nr.04/2016 për Bashkëpunim Institucional të miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, më datë 22.04.2016, ju njoftoj se kemi pranuar njoftimin PP.II.nr.44/2018 më datë 22.10.2019 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, se kundër të pandehurit Drejtor i Departamentit të Automjeteve në Ministrinë e Infrastrukturës, janë duke u zhvilluar hetimet për veprën penale „Keqpërdorim io pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par 1. Lidhur me nenin 31 të KPRK-së”*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 08.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 26.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2874/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 08.11.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 08.10.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa me numër protokollit 4699/2019 e datës 08.10.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Vendimin me Nr. Prot: 10443 të datës 24.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Kërkesë e datës 01.10.2019 e ankuesit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit; Përgjigje në kërkesë e datës 02.10.2019 nga Udhëheqësja e Divizionit të Personelit për ankuesin; Kërkesë Gjykatës Themelore në Prishtinë nga Ministria e Infrastrukturës e datës 13.12.2018; Njoftim i datës 10.01.2019 nga Gjykata Themelore në Prishtinë për Ministrinë e Infrastrukturës; Certifikatën nga Gjykata Themelore në Prishtinë për ankuesin e datës 27.09.2019; Përgjigjen në ankesë e datës 15.10.2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit; Kërkesën për informata zyrtare e datës 16.10.2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Kryeprokurorin e Shtetit; Njoftimin e datës 23.10.2019 nga Prokurori i Shtetit; Kërkesën për informata e datës 18.02.2021 për ankuesin; Njoftimin e datës 17.03.2021 të ankuesit; Aktgjykimin A.nr.2874/19 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin me nr. 3154 i datës 26.03.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit; Aktvendimin AA.nr.150/2020 i datës 20.02.2020 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktvendimin A.nr.2874/19 i datës 17.01.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktvendim AA.nr.914/2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktvendim A.nr.2874/19 i datës 06.12.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Njoftimin për ankuesin i datës 08.11.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës dhe njoftimin e datës 17.03.2021 të ankuesit, ka konstatuar



se objekti për të cilin për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit, është bërë i pamundur, *sepse*:

Fillimisht përmes telefonit pastaj më datë 18.02.2021, kemi komunikuar me e-mail, duke kërkuar nga ankuesi të na njoftoj që a ka hapur konflikt administrativ ndaj Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës meqenëse nuk është vendosur për ankesën e tij.

Ankuesi përmes e-mailit më datë 17.03.2021 ka njoftuar “*Siç Ju kam njoftuar edhe përmes telefonit, në ndërkohë jam kthyer në vendin e punës sipas akt emërimit. Prandaj, konsideroj se nuk është e nevojshme të vazhdohet me procedura të mëtutjeshme*”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës respektivisht Vendimin me Nr. Prot:3154 të datës 26.03.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, ka konstatuar se ankuesi, është kthyer në vendin e tij të punës Drejtor i Departamentit të Automjeteve sipas akt emërimit.


Duke ju referuar shkesave të lëndës respektivisht njoftimit të datës 17.03.2021 të ankuesit, ka konstatuar që procesi i ankimit i filluar sipas ankesës së ankuesit përfundon meqenëse ankuesi ka tërhequr ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rrjedhimisht në kuptim të dispozitave të nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: ***”Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”***, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.438/2021

Avdyl BEKTESHI
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsorë Gashi-BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

